

## Legjionaret/ Vajushi shenon per Liteksin

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 14 Shtator 2013 22:19

---



Armando Vajushi eshte kthyer ne nje lider tek skuadra e Liteksit. Sulmuesi shkodran ka shenuar nje tjetër gol me vlere për ekipin e tij që ka barazuar me Slavian e Sofies në shtëpi. Vajushi shenoi në minuten e 59 golin e barazimit për Liteksin që pas këtij barazimi ruan vendin e dytë në tabelën e klasifikimit. Në këtë ndeshje luajti dhe shqiptari tjetër Jurgen Gjasula që bënte fantazistin tek Liteksi.